



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:015212

Datë: 20.12.2023

Numri i dokumentit: 05096679

C-III-12-0219

Parashtruesi

Këshilli Prokurorial i Kosovës, rr. “Luan Haradinaj” nr. 100, Prishtinë,
(Prokuroria Themelore Prizren – ish Prokuroria Publike Komunale në Prizren)

Kundër:

Të paditurat

- KBI “Progres-Export” Prizren e përfaqësuar nga**
Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.
- RV dhe të tjerët, përfaqësuar nga H S, avokat nga Prizreni.**

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Asllan Krasniqi dhe Bajram Miftari gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 20 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- Refuzohet padia e paditësit si e pa bazuar.**
- Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 10 maj 1994, paditësi Prokuroria Publike Komunale në Prizren dorëzoi në Gjykatën Komunale në Prizren një padi për anulimin e kontratës së shitblerjes ov.nr... e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren më 10 janar..., për ngastrat kadastrale .. vendi i quajtur “L P” në sipërfaqe prej 0.68.39 ha dhe ngastra kadastrale nr... në vendin e quajtur “B” në sipërfaqe prej 0.44.14 ha, në listën poseduese nr.... ZK Prizren kundër të paditurave KBI “Progres Export” Prizren, dhe R V dhe të tjerët.

Me 16 janar 2012 Gjykata Komunale në Prizren, me aktvendimin C.nr. 430/01 është shpallur in kompetente lëndore, për vendosje në lidhje me padinë e parashtruesit të parashtruar në Gjykatën

Komunale në Prizren me 16 janar 2012 për anulimin e kontratës së shitblerjes, kundër të paditurave KBI “Progres Export” Prizren, R V dhe të tjerët nga Prizreni dhe lëndën e ka dërguar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, si gjykatë me kompetencë ekskluzive, në këtë çështje juridike.

Me 23 shkurt 2012, lënda u regjistrua në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, përkatësisht në Kolegjin për çështje pronësore nën numrin C-III-12-0219.

Me 08 qershor 2015, e paditura parashtrori mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL i kundërshton të gjitha pretendimet e parashtruesit duke i konsideruar si të pabazuara në ligj. Agjencia e njofton DHPGJS se NSH “KBI Progres Export, Lavërtari dhe Blegtori” Prizren më datë 07 korrik 2014, me vendim të Bordit të Agjencisë ka shkuar në procedurë të likuidimit. Në bazë të Nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë, çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i vendimit për likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të vendimit për likuidim nga ana e AL në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Prandaj, pezullimi i procedurave në lidhje me padinë e parashtruesit nga kjo ndërmarrje, jo vetëm që është i ligjshëm, por është edhe shumë i arsyeshëm. E paditura më tej thekson se duke pasur parasysh se padia është parashtruar nga Prokuroria Komunale në Prizren me 10 maj 1994 dhe se kjo çështje pas luftës është iniciuar përsëri dhe duke konsideruar se gjatë kësaj kohë kanë ndryshuar edhe rrethanat faktike dhe juridike si dhe kompetencat e prokurorit publik, me nxjerrjen e ligjeve të reja duhet që parashtruesi të deklarohet nëse ka interes ligjor për të vazhduar këtë çështje juridike dhe duhet konstatuar se cilat janë palë në procedurë. Nga kjo që u tha më lartë konsiderojmë se kjo çështje juridike është kthyer nga fillimi dhe se pretenduesi nuk ka asnjë titull juridik mbi bazën e të cilit mund të kërkon anulimin e kontratës. E paditura më tej thekson se sipas informatave që disponon Zyra Regjionale e Agjencisë në Prizren, parcela .. ka pësuar ndarje në 4 parcela:..., ..., dhe ... dhe se asnjëra nga këto parcela aktualisht nuk është e regjistruar në emër të NSH. Parashtruesi e mbështet padinë me Nenin 103 të LMD koha kur është lidhur kontrata është e viteve 60, ndërsa LMD ka hyrë në fuqi në vitin 1978, çka nënkupton se nuk mund të zbatohen dispozitat e LMD-së në këtë rast pasi që në bazë të Nenit 1106 të LMD-së në mënyrë eksplicite thekson se dispozitat nuk do të zbatohen për obligimet e krijuara para kohës kur ka hyrë në fuqi e që është me 01 tetor 1978. Mbi këtë bazë padia e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në rastin SCC-08-0112. Parashtruesi megjithëse pretendon se kontrata është nule, nuk ka dëshmuar se e njëjta është në kundërshtim me dispozitat e Nenit 103 të LMD. Parashtruesi pretendon se shitësi, ka qenë nën presion por nuk kanë paraqitur kurrfarë dëshmie lidhur me ato rrethana, neni 60 LMD parasheh: “*Frika konsiderohet e bazuar në qoftë se nga rrethanat shihet se nga rreziku serioz është cenuar jeta, trupi ose ndonjë e mirë tjetër e rëndësishme e palës kontraktuese ose e personit të tretë*”. Gjykata në bazë të shqyrtimit paraprak të padisë në kuptim të Nenit 391 të LPK-së ligji nr.03/L-006 është dashur të shqyrtoj nëse padia për anulimin e kontrate është e afatshme, pasi që kontrata është lidhur në vitet e 60-ta ndërsa padia është parashtruar në vitin 1995. E paditura më tej thekson se duke u bazuar në kopjen e kontratës të ofruar nga parashtruesi si dëshmi, se në kohën e lidhjes së kësaj kontrate ishte në fuqi Ligji për qarkullimin e tokës dhe ndërtesave GZ.Nr.26/54 i plotësuar dhe i ndryshuar sipas ndryshimeve ligjore të publikuara në GZ. Nr.1955,30/6253/62 dhe 43/65. Sipas nenit 22 të Ligjit

për qarkullimin e tokës dhe ndërtesave GZ 26/54 organizatat bujqësore kishin të drejtë të lidhin kontratë për blerjen e tokës bujqësore nga personat fizik. Palët e pakënaqura në bazë të Nenit 26 të këtij ligji kishin të drejtë kontestimi të kësaj kontrate brenda afatit prej 1 viti, te gjykata e rrethit përmes prokurorit publik. Andaj nga kjo rezulton se është parashkruar kërkesa e parashtruesit dhe se këtu kemi të bëjmë me parashkrim absolut bazuar në ligjet në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës. Nga kjo rrjedh se në bazë të Nenit 268 (GZ e RSFJ, 53/76) i LPB i cili parasheh se *“Nëse pasuria e paluajtshme është bërë pasuri publike pabazë ligjore, mund të ngritët padi (kërkohet) për kthimin e saj brenda një periudhe prej 5 vjetësh, nga data kur është mësuar për të, por jo më shumë se 10 vjet nga ai fakt”*. Mbi këtë bazë padia e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në rastin nr.SCC-09-0098. E paditura i propozon gjykatës që ta hedh poshtë padinë e parashtruesit si të papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj, dorëzoi dëshmitë në kopje si: Vendimin me nr. ref.BD-57/11 datë 27 maj 2014, Njoftimin për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes dhe Publikimin në gazetë ditore të datës 14 korrik 2014, Certifikatat kadastrale të lëshuara nga Komuna e Prizrenit si në vijim: nr. P-71813068-09000-0 pronar A (Sh) Xh, nr. P-.....pronar M (Sh) Xh, nr....., nr. P-.....dhe nr. P-.....pronar Sh (I) K.

Me 27 tetor 2023, Këshilli Prokurorial i Kosovës pas pranimit të urdhrin të gjykatës i cili ishte dorëzuar tek Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, dorëzoi përgjigjen e tij në mbrojtje. Padiësi thekson se pas shqyrtimit dhe analizimit të mbrojtjes së paraqitur nga e paditura të njëjtën e kundërshtojmë në tërësi dhe i propozojmë gjykatës që mbrojtjen e parashtruar nga e paditura ta refuzoj dhe të vazhdoj procedura në rastin konkret dhe se lidhja e kësaj kontrate për shitblerjen e paluajtshmërisë nuk ka ardhur më vullnet të shprehur lirisht, por nën presion dhe dhunën e ushtruar nga aktivistët e komunës dhe komitetit gjatë zbatimit të vendimit të KK të Prizrenit për formimin e Kombinatit Industrial Bujqësor Progres në Prizren. Toka e blerë nga kombinati nuk është shfrytëzuar për qëllimin për të cilin është blerë por pas një kohe të shkurtër rreth vitit 1970 parcelat i janë dhënë në shfrytëzim personave të tjerë dhe si rrjedhojë kontrata në fjalë e shitblerjes së paluajtshmërisë është lidhur në kushte presioni dhe dhune, pra kushte që nuk garantohej ligjshmëria dhe barazia e kombeve, kombësive dhe siguria e njerëzve dhe e pronës, gjë që sipas dispozitës së nenit 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transferimin e paligjshmërisë RSS, e bën atë absolutisht të pavlefshëm. Prandaj, në bazë të Nenit 103 par.1 i LMD kjo kontratë është në kundërshtim me parimet e përcaktuara kushtetuese të organizimit shoqëror me rregulla të detyrueshme dhe moralin e shoqërisë socialiste, kështu që prokurori publik komunal bazuar në nenin 109 të të njëjtit ligj, ka paraqitur padi dhe ka propozuar që gjykata këtë kontratë të shitblerjes ta shpallë të pavlefshme dhe i propozojmë gjykatës që ta aprovoj në tërësi padinë si të bazuar.

Me 08 dhjetor 2023, e paditura dorëzoi kundërpërgjigjen e saj, përmes së cilës i kundërshton të gjitha pretendimet e parashtruesit të paraqitura në kundërshtim të saj ndaj përgjigjes në padi, si të pabazuara në prova dhe ligj dhe njëherit qëndrojmë pranë të gjitha thënieve dhe provave të dorëzuara në mbrojtje në padi. Parashtruesi në parashtrësën e tij nuk ka prezantuar ndonjë provë, dëshmi apo fakt të ri, në mbështetje të pretendimeve të tij por është përsëritur dhe i ka ricikluar theksimet e tij si në padi. Në shkresat e lëndës, më tepër ka supozime sesa fakte dhe prova në argumentim të pretendimeve në këtë çështje juridike. Provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës,

tregojnë tërësisht për një gjendje tjetër faktike siç e paraqet parashtruesi. Parashtruesi thekson se kontrata e shitblerjes anulimi i së cilës kërkohet ishte lidhur me vullnetin e paditësit por e njëjta është lidhur nën presionin dhe dhunën e ushtruar nga autoritetet e kohës mirëpo me asnjë provë të vetme nuk e ka dëshmuar këtë. Pra, parashtruesi përveç në mënyrë deklarative me asnjë provë nuk i ka argumentuar pretendimet e tija. Parashtruesi insiston se kontrata në bazë të Nenit 103 par.1 të LMD-së është lidhur në kundërshtim me parimet e përcaktuara kushtetuese të organizimit shoqëror mirëpo ky konstatim nuk qëndron dhe është pa mbështetje ligjore. Kontrata e shitblerjes ishte lidhur para se LMD-ja të hynte në fuqi andaj ky ligj sikurse ligjet tjera nuk veprojnë prapa në kohë. E paditura vlerëson se padia është ushtruar në kundërshtim me Nenin 35.2.1 të Ligjit Nr.06/L-086 për DHPGJS si dhe Nenin 253 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore pasi që padisë përveç që i mungojnë elementet thelbësore të saj, veçanërisht i mungojnë argumentet ligjore dhe/ose faktet mbi të cilat parashtruesi e mbështet kërkesën dhe po ashtu mungojnë provat si dhe baza juridike e kërkesës. E paditura i propozon gjykatës që të vendos si në propozimin e dhënë në mbrojtjen e saj në padi.

Për detaje tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Padia refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban padia nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtruesat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e palëve dhe dëshmitë e dorëzuara në procedurën me shkrim në këtë rast dhe vlerëson se ndër pretendimet kryesore të palëve në lidhje me objektin e kontestit

mbetet çështja e ekzistimit të presionit apo dhunës për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes (anulimi i së cilës ishte iniciuar në atë kohë nga Prokuroria Publike Komunale në Prizren në bazë të ligjit të atëhershëm për mbrojtjen e interesit publik), në këtë rast personave fizikë kundrejt ndërmarrjes shoqërore gjatë zbatimit të vendimit të KK të Prizrenit për formimin e Kombinatit Industrial Bujqësor Progres në Prizren.

Gjykata gjen se padia është parashtruar nga Prokuroria Komunale në Prizren me 10 maj 1994 dhe se kjo çështje pas luftës është iniciuar përsëri. Siç, argumenton e paditura në mbrojtjen e saj se prej momentit të parashtrimit të padisë dhe gjer më tani ka kaluar një kohë e gjatë dhe rrjedhimisht kanë ndryshuar edhe rrethanat faktike dhe juridike si dhe kompetencat e prokurorit publik. Këshilli Prokurorial i Kosovës në përgjigjen e tij në mbrojtjen e të paditurës ndër të tjera ka theksuar se e kundërshton në tërësi mbrojtjen e të paditurës dhe i propozon gjykatës që të njëjtën ta refuzoj dhe të vazhdoj procedura në rastin konkret.

Duke u nisur nga kjo gjendje, gjykata vlerëson se përgjatë kësaj kohe kanë ndryshuar plotësisht rrethanat faktike dhe juridike, me nxjerrjen e ligjeve të reja në një sistem krejtësisht të ri ligjor në Republikën e Kosovës, prandaj në vijim jep arsyet për refuzimin e padisë.

Gjer më tani, Republika e Kosovës nuk ka miratuar ndonjë ligj për kthimin e pronave respektivisht shqyrtimin e rasteve apo kontratave për paluajtshmëritë, kontrata të lidhura në të kaluarën, anulimi i të cilave mund të kërkohet. Nën kornizën e re ligjore të periudhës së pasluftës edhe roli i Prokurorit Publik atëherë, tash Prokurori i Shtetit veçse ka ndryshuar dhe nuk është në mandatin e tij inicimi apo vazhdimi i procedurave të tilla, siç ishte paraparë me legjislacionin e atëhershëm, e cili legjislacion megjithatë i referohej një periudhe të caktuar kohore për të zhvilluar procedurat e tilla nën kushtet e përcaktuara me ligjin e atëhershëm. Prandaj, gjykata nuk gjen ndonjë bazë ligjore në të cilën aktualisht mund të mbështetet për të vazhduar këtë procedurë, rrjedhimisht edhe padia duhet të refuzohet si e pabazuar. Për më tepër, edhe interesi ligjor për të vazhduar këtë çështje juridike në rrethanat aktuale është i munguar në kuptim të interesit të përgjithshëm për të cilin kujdeset zyrtarisht Prokurori i Shtetit.

Veç tjerash, argument thelbësor në të cilin është referuar pala paditëse është se kontrata ishte lidhur në ndikimin e dhunës dhe kërcënimit. Këto rrethana nuk janë provuar me asnjë provë nga pala paditëse mirëpo edhe sikur të ekzistonin rrethanat e tilla, paraqesin bazë ligjore për rrëzueshmërinë e kontratës objekt kontesti dhe jo për nulitetin e saj. Sipas nenit 117 LMD të vitit 1978, afati subjektiv për të kërkuar anulimin e kontratës për shkak të dhunës dhe kërcënimit është 1 vit, ndërsa afati objektiv është 5 vite. Meqenëse kontrata objekt kontesti është lidhur në vitet e 60-ta, ndërsa padia për anulimin e saj është paraqitur në vitet e 90-ta, rezulton se kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për të kërkuar anulimin e saj.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Asllan Krasniqi, gjyqtar

Bajram Miftari, gjyqtar